

30/10/2017  
Prishtinë, Kosovë

**Drejtuar:** z.Dardan Gashi-t, zv.Kryeministër/Ministër në Ministrinë e Diasporës dhe Invenstimeve Strategjike, Republika e Kosovës.

**Nga:** OJQ Germin

**Tema:** Projektligji i Diasporës: Çfarë sjellë?

I nderuar z. Gashi,

Më 14 tetor 2017, organizata jo-qeveritare Germin, në kuadër të iniciativës *Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës* ([www.diasporaflet.org](http://www.diasporaflet.org)) ka mbajtur takimin virtual (Google Hangout) me temën *Projektligji i Diasporës: Çfarë sjellë?*

Në këtë takim ishin prezent:

1. Brikena Muharremi (avokate), Londër, Mbretëria e Bashkuar.
2. Hilmi Gashi (eskpert në migracion), Bernë, Zvicër.
3. Liza Gashi (drejtoreshë e programeve në Germin), Prishtinë, Kosovë.
4. Muhamet Idrizi (mësimdhënës i gjuhës gjermane dhe shkencës politike), Stuttgart, Gjermani.
5. Behar Isma (Ushtrues detyre në Divizionin Ligjor në Ministrinë e Diasporës dhe Invenstimeve Strategjike), Prishtinë, Kosovë.

Diskutimi u moderua nga Fjolla Vukshinaj, koordinatorë e nismës Dialogu i Strukturuar për të Drejtat e Diasporës.

Ligji aktual për diasporën, i miratuar në vitin 2012 që ka për qëllim të ruaj dhe të kultivojë identitetin gjuhësor, kulturor dhe arsimor të diasporës, pritet që në përbërjen e saj të ketë ndryshime përmbajtësore. Për dallim nga projektligji i kaluar, në këtë projektligj presim nga ana juaj që të punohet më shumë, dhe se për ndryshimet në draftligjin për Diasporën të merren për bazë sugjerimet dhe vërejtjet të cilat vijnë nga mërgata shqiptare në diasporë, si shqetësime të cilat ata preken direkt edhe nga rregullimi ligjor të cilin do ta ofrojë ky projektligji.

Prandaj, bashkëbisedimi me pjesëtarët nga diaspora për Projektligjin e Diasporës kishte si qëllim realizimin e një diskutimi të frytshëm, ku ata mund t'i kalonin kritikën dhe sugjerimet e tyre për një projektligj më gjithëpërfshirës, më përmbajtësor dhe më të aplikueshëm. Me këtë Projektligj, Qeveria e Republikës së Kosovës dhe institucionet e tjera obligohen që të krijojnë mekanizma në forcimin e marrëdhënieve dhe bashkëpunimit në mes të Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës.

Mirëpo, ndryshimet e draftligjit duhet të bëhen konform kërkesave të diasporës dhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave shoqërore, politike dhe ekonomike si dhe në ruajtjen e vlerave kulturore dhe identitare.

Për këtë arsye, ne po ju dërgojmë disa nga rekomandimet e dala nga ky diskutim, të cilat mund të ju ndihmojnë në lehtësimin e hartimit të draftligjit.

- **Neni 1:** Të vendosen të drejtat ekonomike dhe kulturore, karshi të drejtave politike dhe sociale të diasporës:

(Ky ligj ka për qëllim rregullimin e raporteve ndërmjet Republikës së Kosovës dhe pjesëtarëve të diasporës, përcaktimin e statusit të pjesëtarëve të diasporës, *mbrojtjen e të drejtave sociale, politike, kulturore dhe ekonomike*)

- **Neni 2:** Pika 1.4 të përmirësohet dhe të shtohet pjesa: promovimin e bashkëpunimit ekonomik në mes të Republikës së Kosovës, **kuadrave të fushave të ndryshme** dhe komunitetit të bizneseve të diasporës, si dhe me kudo ku ndodhet diaspora.
- **Neni 3:** Pika 1.5 fjala QKD të zëvendësohet me **Qendra apo Shtëpia e Diasporës**. Po ashtu, pika 1.1 e këtij neni "Qarkullimi i trurit: nënkupton lëvizja rrethore e punës së kualifikuar në mbarë botën", të zëvendësohet me **Angazhim i profesionistëve nga diaspora; kthimi i trurit**.
- Tek neni 11 "Institucionet Përgjegjëse" të specifikohet se cilat janë institucionet e tjera përgjegjëse, për diasporën përshkak të konfuzionit dhe ngatërimit të kompetencave. P.sh: Ministria e Drejtësisë dhe Punëve të Brendshme për çështjet e shtetësisë, marrëveshjeve bilaterale.
- **Neni 12:** Të zëvendësohet termi "Ministria e Diasporës", me **Qeveria e Kosovës dhe institucionet e saja**, marrin përsipër obligimet për mësimin plotësues të gjuhës shqipe në diasporë. Edhe në nenet 15, 19, 20, 21, 24 të bëhen këto ndryshime.
- Në **nenin 12**, të vendoset një paragraf i cili obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës të perkthejë kurikulën e mësimin të gjuhës shqipe në gjuhën gjermane.
- **Neni 12** t'i shtohet paragrafi: "*Ministria promovon përfshirjen e gjuhës shqipe si lëndë zgjedhore në planprogramet e shkollave shtetërore fillore dhe të mesme në vendet ku jetojnë pjesëtarët e diasporës*".
- Të qartësohet **neni 16 Statusi rreth pjesëtarit të diasporës** dhe **neni 17 Procedurat për marrjen e statusit të pjesëtarit të diasporës**, apo të largohen sepse krijojnë konfuzion. Kjo mund të zëvendësohet kështu: **Secili qytetarë apo qytetare i/e RKS, anëtarët e tyre të familjes, të cilët jetojnë jashtë territorit të Republikës së Kosovës janë pjesëtar të Diasporës**.
- Të përfshihen në ligjin aktual kuotat për studentët nga diaspora për studime, punë praktike apo hulumtime në institucionet e Republikës së Kosovës.
- Të vendoset një kapitull i veçantë për të drejtat qytetarë si: Votimi Jashtë Vendi, përfaqësimin e diasporës në institucionet, agjencionet dhe organet qeveritare: Kuvendi i Republikës së Kosovës, Komisioni Qendror Zgjedhor etj.
- Të shtohet një nen për Filantropinë Shqiptare në Diasporë.
- Përveç bashkëpunimit në fushën e sportit, të shtohet një nen/paragraf për bashkëpunim në fushën e drejtësisë, shkencës, artit.
- Të krijohet një nen i cili obligon ministritë që lidhjet e marrëveshjeve bilaterale të hulumtohen dhe Qeveria e Republikës së Kosovës të ruajë interesat e mërgatës në rastin e lidhjes së marrëveshjes biletarele me shtetin tjetër.
- Të krijohet një nen i posaçshëm i cili u lejon profesionistëve me origjinë nga Kosova, të angazhohen në Kosovë pa pasur nevojë të marrin licencë dhe leje pune të veçantë, por t'i përdorin licencat e punës në vendet ku jetojnë.
- Të krijohet një nen i posaçshëm i cili mbron të drejtat e kthimit në vendlindje të pjesëtarëve të diasporës, si dhe të mbrojtë pjesëtarët e diasporës që janë të detyruar të heqin dorë nga nënshtësia kosovare.
- Të përmirësohet gjuha në aspektin gjinor. P.sh në nenin 25, pika dy, përmenden vetëm biznesmenët shqiptarë, por jo edhe gratë sipëmarrëse.

Prandaj, duke marr parasysh që mërgata shqiptare përbën një prej grupeve më të mëdha sociale në Kosovë, shpresojmë që ky projektligj të jetë sa më gjithëpërfshirës dhe i mbron të drejtat politike, sociale, kulturore dhe ekonomike të tyre.

Me respekt,

Liza Gashi  
Drejtoreshë e Programeve, Germin

